



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. _____ prot.

Tiranë, më 27.5.2022

Lënda: Bisedime përfundimtare të Komisionerit Publik në çështjen ankim kundër vendimit nr. 229, datë 28.1.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, z. Dritan Banushi

Baza ligjore: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

Drejtuar: Kolegjit të Posaçëm të Apelit

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

Në referencë të nenit 302 dhe 303 të Kodit të Procedurës Civile, pasi u shqyrtuan dhe iu nënshtruan debatit gjyqësor të gjitha shkaqet e ankimit, prapësimet e palëve dhe provat e administruara nga Kolegji, në cilësinë e provës gjatë hetimit gjyqësor, në përfundim, duke i qëndruar të gjitha shkaqeve të ankimit dhe parashtrimeve të paraqitura në këtë gjykim, në seancat gjyqësore të datave 26.4.2022 dhe 20.5.2022, konstatohet se pretendimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit nuk arritën të provojnë të kundërtën e shkaqeve të ankimit. Në përfundim, Komisioneri Publik, vlerëson se:

1 *Për shkakun ankimor, për pasuritë “Likuiditete në sistemin bankar dhe në cash”*

1.1 Përfundimet në ankim për këtë shkak janë se, *referuar analizës financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, për periudhën 2003-2016, në kuptim të nenin D, pika 1 dhe 3, të aneksit të Kushtetutës, dhe nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit nuk mbulon me burime nga të ardhura të ligjshme shpenzimet e deklaruara dhe kursimet në formën e likuiditeteve në depozitat bankare me burim të deklaruar kursimet cash ndër vite.*

1.2 Lidhur me këtë shkak ankimi, pas vënies në dispozicion të analizës financiare nga ana e Komisionerit Publik, subjekti i rivlerësimit, në seancën e datës 20.5.2022, kundërshtoi zërat përbërës të analizës financiare të Komisionerit Publik, që lidhen me: (i) Llogaritë/vërtetimet bankare; (ii) Leximin e saktë të deklarimeve të subjektit në DVP, në ILDKPKI; dhe (iii) Tabelën standarde të shpenzimeve të jetesës, që INSTAT ka përcjellë në ILDKPKI.

1.3 Komisioneri Publik, për sa i përket pretendimeve të subjektit, arsyeton si vijon:

1.3.1 Për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit mbi të dhënat bankare apo “flukset hyrëse” në zërin: “Të ardhura nga pagat” (për subjektin dhe bashkëshorten), Komisioneri Publik, sikundër ka detajuar në analizën financiare në funksion të ankimit, të paraqitur pranë Kolegjit, i ka llogaritur këto të ardhura bazuar në “Vërtetimin nr. **, datë **.1.2017”, të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, për subjektin dhe aktet “Vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare”, për të ardhurat e bashkëshortes.

1.3.2 Marrë në konsideratë pretendimin e subjektit mbi llogaritjen e zërit: *Të ardhura nga pagat*, referuar flukseve hyrëse në llogaritë respektive bankare, vlerësohet se duhen përfshirë vetëm ato kreditime, të cilat kanë përshkrimin që lidhen me pagën mujore apo shpërblime nga institucionet respektive, pa përfshirë në to të ardhurat e identifikuar nga dietat, bazuar kjo në jurisprudencën e Kolegjit mbi këtë çështje (vendimi (JR) nr. 7/2019 etj.).

1.4 Për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit mbi të dhënat bankare, në zërin: “*Në llogaritë bankare*”, Komisioneri Publik ka përfshirë në analizë balancat e llogarive bankare të subjektit dhe të personave të lidhur me të, në datën 31 dhjetor të çdo viti analizues, bazuar në konfirmimet e institucioneve financiare bankare, të administruara në dosje të Komisionit.

1.5 Për sa i përket pretendimeve të subjektit mbi vlerat monetare të siguruara nga deklarimi ndër vite të subjektit në ILDKPKI, në zërin: “*Në cash sipas deklaratave*”, Komisioneri Publik vlerëson të ritheksojë se, sikundër trajtuar dhe në ankimin e datës 12.3.2020 (në pikën 18 të ankimit) kursimet në *cash* të subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur me të janë konsideruar në analizën financiare sipas deklarimit të subjektit në deklaratat periodike vjetore, bazuar edhe në jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit, mbi trajtimin e likuiditeteve *cash*¹, jashtë sistemit bankar. Pretendimet e subjektit mbi gjendjen *cash* në prapësimet e paraqitura në Kolegj (tabela nr. 6, f. 10 e prapësimeve të datës 18.5.2022), nuk përputhen me deklaratimet e subjektit në deklaratat periodike vjetore².

1.5.1 Bazuar në prapësimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit në seancat e datës 26.4.2022 dhe 20.5.2022, Komisioneri Publik vlerëson të marrë në konsideratë vetëm pretendimet lidhur me kursimet *cash* të vitit 2016, duke i konsideruar ato në vlerën 300.000 lekë, në fund të këtij viti (1.000.000 lekë kursim, të deklaruar të vitit i zbrerim shumë 700.000 lekë, të deklaruar si të depozituar në Bankën *** ***)

1.6 Për sa i përket pretendimit të subjektit mbi shpenzimet e jetesës së vitit 2007, Komisioneri Publik sjell në vëmendje se shuma e llogaritur në analizën financiare, të paraqitur në funksion të shkaqeve të ankimit, bazohet në shpenzimet e jetesës sipas standardit të përcaktuar nga INSTAT

¹ Komisioneri Publik e bazon qëndrimin e tij në jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit, vendimet (JR) nr. 11/2019; (JR) nr. 19/2019; (JR) nr. 20/2019; (JR) 7/2019 dhe (JR) nr. 27/2020.

² Sikundër trajtuar dhe në pikën 18 të ankimit, Komisioneri Publik për vitet kur, nga analiza financiare ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, nuk mbulojnë me burime të ligjshme kursimet e deklaruara, këto kursime nuk janë marrë në konsideratë si burim për mbulimin e shpenzimeve të vitit pasardhës dhe nuk janë përfshirë në gjendjen *cash* të akumuluar, të deklaruar të përdorur nga subjekti në vitin pasardhës.

për ILDKPKI-në, për vitin 2007 (shkresa nr. *** prot., datë **.3.2019, e ILDKPKI-së³), llogaritur sipas kësaj shkrese për një familje të përbërë prej 4 personash.

1.7 Subjekti i rivlerësimit në parashtrimet e tij ka pretenduar edhe përfshirjen e shumë 290.000 lekë, si dhurim ndaj vajzës nga prindërit e tij, në vitin 2013. Komisioneri Publik, për sa ka trajtuar dhe në ankimin e datës 12.3.2020, vlerëson të mos e përfshijë këtë vlerë, për sa kohë ajo nuk rezulton e deklaruar nga subjekti në deklaratën periodike vjetore 2013, të dorëzuar në ILDKPKI, në përmbushje të detyrimit që rrjedh nga ligji nr. 9049/2003, i ndryshuar, por as në përgjigje të Pyetësorit nr. 1, pyetja 2, të hetimit administrativ, të kryer nga Komisioni. Gjithsesi, edhe nëse do të merret në konsideratë ky pretendim i subjektit të rivlerësimit, përfshirja e kësaj shume ka një efekt të papërfillshëm në pamjaftueshmërinë totale të konstatuar.

1.8 Në përfundim, Komisioneri Publik, sa më sipër, vlerëson se, edhe në rast të rishikimit të analizës financiare për zërat: (i) “Të ardhura nga pagat”, sipas pasqyrave të llogarive bankare “*flukset hyrëse*” (pa përfshirë të ardhurat nga dietat) dhe (ii) “Kursime në *cash*”, për vitin 2016, rezultatet lidhur me pamjaftueshmërinë financiare ndër vite nuk do të ishin të asaj mase sa të ndryshonin shkaku e ankimit.

2 *Për shkakun ankimor, për pasurinë “Apartament banimi në posedim, me sipërfaqe 85,5 m², ndodhur në lagjen “***”, Gjirokastër*

2.1 *Lidhur me gjendjen faktike të apartamentit në momentin e blerjes*, ku subjekti i rivlerësimit pretendon se apartamenti me sipërfaqe prej 85,5 m² është blerë në gjendje “karabina”, subjekti i rivlerësimit, gjatë shqyrtimit të çështjes në seancat gjyqësore në Kolegj, paraqiti disa akte të reja, të cilat nuk ndryshojnë vlerësimin e Komisionerit Publik lidhur me këtë shkak ankimi. Pretendimet e subjektit të rivlerësimit, lidhur me statusin “karabina” të apartamentit, në momentin e blerjes, mbetën të paprovuara dhe nuk gjejnë mbështetje as në provat e administruara rishtas gjatë hetimit në Kolegj.

2.1.1 Konkretisht, nga ana e Kolegjit është administruar, me cilësinë e provës, praktika e regjistrimit të pasurisë me nr. ***, e përcjellë me shkresën nr.*** prot., datë **.3.2021, nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Gjirokastër, ku konfirmohet se është bërë regjistrimi i kësaj pasurie sipas ligjit të kohës për “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe akteve rregullative të dala në zbatim të tij, bazuar në këto akte: (i) Vendim i KRT-së, Bashkia Gjirokastër, nr.**, datë **.3.2002; (ii) Leje ndërtimi, lëshuar nga Bashkia Gjirokastër, për subjektin ndërtues firma “****”, datë **.3.2002; (iii) Procesverbal kolaudimi, datë **.1.2003; (iv) Leje e shfrytëzimit, e lëshuar nga Bashkia Gjirokastër, nr.*** prot., datë **.1.2003. Mbi bazën e dokumentacionit të mësipërm është regjistruar titulli i pronësisë për shoqërinë “****” sh.p.k., sipas Vërtetimit nga dokumentet hipotekore nr.**, datë **.1.2003.

2.1.2 Nga krahasimi i dokumentacionit të depozituar si provë nga vetë subjekti në Kolegj, rezulton se akti i kolaudimit, datë **.1.2003, është i njëjti dokument me atë të administruar në dosjen e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

³ Me kërkesë të Kolegjit, gjatë seancës së datës 20.5.2022, ky akt shkresor iu vu në dispozicion dhe palëve.

2.1.3 Përkundër pretendimit të subjektit në parashtrimet e tij, dorëzuar në seancën gjyqësore në Kolegj, datë 26.4.2022, se akti i kolaudimit të objektit ndërtimor (pallatit), ku ndodhet apartamenti me sipërfaqe 85.5 m², ka qenë fiktiv, rezulton se ky procesverbal është administruar si pjesë e dokumentacionit që ka shërbyer për regjistrimin në ZVRPP-në Gjirokastrë, e cila e rikonfirmon edhe me dokumentacionin bashkëlidhur shkresës datë **.3.2021. Bazuar në parashikimet e ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, procesverbal akti i kolaudimit, datë **.1.2003, është garanci teknike dhe ligjore për dhënien e lejes së shfrytëzimit.

2.1.4 Pas kolaudimit të objektit, Bashkia Gjirokastrë ka lëshuar *Lejen e shfrytëzimit nr. *** prot.*, datë **.1.2003, me objekt “Godina Banesë masive + lokale (lagjja “***”), bazuar në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998. Kjo leje, shprehimisht, përcakton se: *shfrytëzimi i objektit ka filluar në datën **.1.2003*, që daton para datës së blerjes së pasurisë nga babai i subjektit, me kontratën e shitjes nr.*** rep., nr. *** kol., datë **.9.2003.

2.1.5 Komisioneri Publik, bazuar edhe në provat e administruara gjatë gjykimit në Kolegj, dhe referuar jurisprudencës së Kolegjit⁴, i rezulton që kjo godinë ishte përfunduar përpara regjistrimit të saj në Regjistrin hipotekor me nr. **, datë **.1.2003, me pronar shoqërinë ndërtuese “***” sh.p.k. I gjithë dokumentacioni i administruar, si gjatë gjykimit në Komision, ashtu dhe në Kolegj, i cituar më sipër, që ka shërbyer për regjistrimin e kësaj godine, provon që kemi të bëjmë me një ndërtim të përfunduar dhe në gjendje teknike për shfrytëzim/banim, që në vitin 2003. Si rrjedhojë, subjekti nuk provoi faktin e pretenduar prej tij, se apartamenti është në gjendje “karabina” në momentin e blerjes.

2.2 *Lidhur me çmimin e blerjes së këtij apartamenti*, Komisioneri Publik, bazuar sa më sipër, vlerëson se pasuria ka qenë e përfunduar në vitin 2003. Referuar Udhëzimit të EKB-së, nr. 1, datë 8.5.2003, “Për miratimin e kostove mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave”, rezulton se vlera e shitjes në tregun e lirë në këtë qytet, sipas po këtij udhëzimi, është në vlerën 2.923.074 lekë.

2.3 *Lidhur me pamundësinë financiare të prindërve të subjektit për të mbuluar me burime të ligjshme, shpenzimet për blerjen e këtij apartamenti*, subjekti i rivlerësimit paraqiti disa akte të reja, të cilat, në vlerësimin e Komisioneri Publik, nuk provojnë të ardhurat e pretenduara të prindërve dhe mundësinë e tyre financiare për të mbuluar me burime të ligjshme blerjen e pasurisë dhe mbulimin e shpenzimeve të tjera të konstatuara.

2.3.1 Përfundimisht, për pasurinë “Apartament 85.5 m²”, Komisioneri Publik vlerëson se, referuar nenit D, pikat 1, 3 dhe 5, të aneksit të Kushtetutës, provohet deklarimi i pasaktë, i pamjaftueshëm dhe mungesa e burimeve të ligjshme për krijimin e të ardhurave të ligjshme, që kanë shërbyer për fitimin e pronësisë nga babi i subjektit të rivlerësimit, mbi pasurinë “Apartament 85.5 m²”.

⁴ Vendimi i Kolegjit (JR) nr. 12/2021.

I. Kërkimi përfundimtar i ankimit

3 Në përfundim të këtyre bisedimeve përfundimtare, Komisioneri Publik, në referencë të analizës së provave/akteve të administruara në dosje të Komisionit, provave dhe akteve të administruara gjatë hetimit gjyqësor, të vendosur nga trupi gjykues, si dhe parashtrimeve dhe akteve/provave të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e provës, gjatë këtij hetimi gjyqësor, duke i qëndruar të gjitha shkaqeve të ankimit të paraqitur prej tij, mbështetur në parashikimet e nenit F, pikat 3 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, nenit 61, pika 3, dhe nenit 66 të ligjit nr. 84/2016, kërkon që shkaqet parashtruara në këtë ankim të merren në konsideratë nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe, në përfundim të gjykimit të çështjes, të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 229, datë 28.1.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Dritan Banushi.

KOMISIONERI PUBLIK

Irena NINO